



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e premte, në datën 08 qershor 2018, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi mori në shqyrtim çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 209, datë 16.09.2016 “Për miratimin e rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive” (**Vendimi nr. 120, datë 08.06.2018**)
2. Miratimin e udhëzimit “Për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA). (**Vendimi nr. 121, datë 08.06.2018**)
3. Heqjen e licencës së shoqërisë “4 Plus Media Group” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat vendor “Tv 4+”; (**Vendimi nr. 122, datë 08.06.2018**)
4. Pajisjen e shoqërisë “Abc News” sh.a., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv ABC News”; (**Vendimi nr. 123, datë 08.06.2018**)
5. Pajisjen e shoqërisë “Scan” sh.a., me licencë shërbimi programi audioviziv “Tv Scan”; (**Vendimi nr. 124, datë 08.06.2018**)
6. Pajisjen e shoqërisë “Focus Media News” sh.p.k., me licencë shërbimi programi audioviziv “TV News 24” (**Vendimi nr. 125, datë 08.06.2018**)
7. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 2 datë 31.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Multiscreen” sh.p.k., zëvendësimin dhe rinovimin e licencës për subjektin audioviziv privat vendor “Report Tv” (**Vendimi nr. 126, datë 08.06.2018**)
8. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në kërkesën për marrjen e autorizimit nga shoqëria “Premium Media” sh.p.k. (**Vendimi nr. 127, datë 08.06.2018**)
9. Pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Aristotel Petro, licencuar për subjektin audio “Radio Alpo” për dhënien e të drejtës së përdorimit të frekuencave 89.8 MHz, 89.5 MHz dhe 90.3 MHz për ofrimin e shërbimit audio përkatësisht në Bashkitë

- Tepelenë dhe Memaliaj, Bashkinë Përmet dhe Bashkinë Këlcyrë. (**Vendimi nr. 128, datë 08.06.2018**)
10. Rrëzimin e aplikimit të shoqërisë “Tele.co” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit në Njësinë Administrative Portëz”. (**Vendimi nr. 129, datë 08.06.2018**)
  11. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit me gjobë nr. 8, datë 08.05.2018, vendosur ndaj shoqërisë “Radio Travel” sh.p.k., licencuar për subjektin audio privat vendor “Radio Travel” (**Vendimi nr. 130, datë 08.06.2018**)
  12. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit me gjobë nr. 06, datë 17.04.2018, vendosur ndaj shoqërisë “Telesport” sh.p.k., autorizuar për subjektin “Tv Telesport”. (**Vendimi nr. 131, datë 08.06.2018**)
  13. Pranimin e ankimit administrativ dhe shfuqizimin e sanksionit me gjobë nr. 07, datë 17.04.2018, vendosur ndaj shoqërisë “Triangle Media Group” sh.p.k., autorizuar për subjektin “City Tv”. (**Vendimi nr. 132, datë 08.06.2018**)
  14. “Rrëzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të sanksioneve me gjobë nr. 570, datë 31.03.2013 dhe nr. 15 datë 13.03.2014, vendosur ndaj shoqërisë “Cable Albania Shkodër” sh.p.k., për subjektin televiziv privat kabllor “TV Cable Albania Shkodër”. (**Vendimi nr. 133, datë 08.06.2018**)

**Tiranë, 8 qershor 2018**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**